

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Raporti 10/2005 i Shtyllës së III-të (OSBE) Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 26 nëntor – 23 dhjetor 2005

Titujt kryesor

- **Mocioni i ORA-s për projektin ndërtimor në Gërmi shqyrtohet pas më shumë se një muaji pas dorëzimit, por akoma nuk është caktuar data e mbajtjes së seancës së jashtëzakonshme plenare¹**
- **Gjashtë deputetë të paanëtarësuar më parë themelojnë një grup të ri parlamentar të quajtur “Për integrim”**
- **Problemet teknike dhe mundësitë për pasaktësi apo manipulim vazhdojnë për shkak të pajisjeve elektronike për votim**
- **Kuvendi miraton Buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006**

1. Sfond

Raporti i dyzetedytë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur një seancë plenare, më 15, 16 dhe 19 dhjetor, dhe një mbledhje të rregullt të Kryesisë më 8 dhjetor. Nëntë komisione si dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike i kanë mbajtur mbledhjet gjatë kësaj periudhe.² Shtylla e tretë (OSBE) e ka monitoruar seancën plenare dhe mbledhjen e Kryesisë, si dhe 24 prej 32 mbledhjeve të komisioneve dhe një dëgjim publik.³

¹ Kryesia, gjatë mbledhjes së saj më 12 janar, pas përfundimit të periudhës raportuese të këtij raporti, ka përgatitur rendin e ditës për seancën plenare të 19 janarit e cila përfshin “debatin sipas kërkesës së Grupit parlamentar të Partisë reformiste ORA”. Në përgjithësi kuptohet edhe pse nuk është përcaktuar në këtë pikë të rendit të ditës se tema e debatit do të jetë projekti ndërtimor në Gërmi dhe shpenzimet nga buxheti i Kuvendit.

² Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 5, 12 dhe 22 dhjetor, derisa Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim është takuar më 7 dhe 14 dhjetor. Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 30 nëntor dhe 5, 8, 12, 13 dhe 14 dhjetor, derisa Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 6 dhjetor. Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe personat e zhdukur është takuar më 29 nëntor, 2, 13, 20, 21 dhe 22 dhjetor, derisa Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 1, 5, 6, 7, 9 dhe 14 dhjetor. Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike është takuar më 7 dhjetor, derisa Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor është takuar më 29 nëntor, 6, 13 dhe 20 dhjetor. Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më 22 dhjetor, derisa Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike është takuar më 29 nëntor dhe 13 dhjetor. Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor ka mbajtur një dëgjim publik të projektligjit për ushqimin më 5 dhjetor.

³ Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese më 5, 12; Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim më 7 dhe 14 dhjetor. Komisioni për buxhet dhe financa më 30 nëntor dhe 5, 8, 12, 13 dhe 14 dhjetor; Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 6 dhjetor; Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe personat e zhdukur më 29 nëntor, 2, 13, 20, 21 dhe 22 dhjetor; Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 1, 5, 6, 7 dhe 9 dhjetor; Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike më 7 dhjetor; Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 6 dhe 13 dhjetor; Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media më 22 dhjetor; Dëgjimi publik i projektligjit për ushqimin më 5 dhjetor.

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 15, 16 dhe 19 dhjetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Nëntëdhjetë e gjashtë, 84 dhe 81 deputetë ishin të pranishëm më 15, 16, përkatësisht 19 dhjetor.⁴
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 15, 16 dhe 19 dhjetorit 2005⁵:
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për provimin e jurisprudencës (Shqyrtimi i dytë i projektligjit është shtyrë për t'i dhënë komisionit funksional më shumë kohë për shqyrtimin e të gjitha amandamenteve të propozuara.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për gjuetinë (Projektligji është miratuar me 76 vota për, dy vota kundër dhe tri abstenime.⁶)
 - **Shqyrtimi i parë dhe i dytë** i projektpropozimit legjislativ për miratimin e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2006⁷ (Projektpropozimi legjislativ është miratuar në parim gjatë shqyrtimit të parë me 47 vota për dhe 19 vota kundër më 15 dhjetor. Më 19 dhjetor është miratuar në shqyrtim të dytë me shumicë votash për, 28 vota kundër dhe dy abstenime.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin (Projektligji është miratuar në parim me 68 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për institucionet e kulturës (Projektligji është miratuar në parim me 72 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe 23 vota kundër. Shiko pikën e dytë nën titullin “Procesi i votimit”.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për operën, baletin dhe filharmoninë e Kosovës (Projektligji është miratuar në parim me 67 vota për.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal (Propozimi është miratuar në parim me 63 vota për.)
 - Shqyrtimi i projektligjit për inspektoratin e produkteve ndërtimore (Projektligji është miratuar në parim me 62 vota për.)
 - Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për siguri (Kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë me kërkesën e LDK-së me arsyetimin se kishte nevojë për më shumë kohë për marrjen e vendimit për themelimin e tij.⁸ Vendimi për shtyerjen e kësaj pike është marrë me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimit për emërimin e deputetit Mahir Yagcilar për anëtar të Kryesisë së Kuvendit (Propozimi është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimit për emërimin e deputetit Džezair Murati për anëtar të Komisionit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike (Propozimi është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit

⁴Këto janë shifrat e njoftuara nga Kryetari i Kuvendit në fillim të secilës ditë të seancës plenare.

⁵ Ish-deputeti i Kuvendit dhe shefi i grupit parlamentar të PDK-së Fatmir Limaj i është drejtuar shkurtimisht Kuvendit para fillimit të seancës plenare më 15 dhjetor. Fjala e tij nuk ishte e përfshirë në rendin e ditës sepse është mbajtur ndaras nga seanca plenare.

⁶ Votat kundër dhe abstenimet nuk janë njoftuar, përveç nëse në raport është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër. Pasi që janë përdorur pajisjet elektronike për votim, i tërë rezultati i votimit është treguar në ekranin në ballë të sallës plenare, por shifrat nuk mund të shihen nga pjesa e vëzhguesve në fund të sallës plenare.

⁷ Në tekstin e mëtejshëm “Buxheti i konsoliduar i Kosovës 2006”.

⁸ Shiko raportin 09/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

- (Kjo pikë është shtyrë sepse nuk ishin siguruar të dhënat biografike për kandidatët e propozuar jashtë Kuvendit. Vendimi për shtyerjen e kësaj pike është marrë me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
- Rekomandimi i Komisionit për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me mocionin e grupit parlamentar ORA (Kryesuesi i komisionit e paraqiti rekomandimin në Kuvend. Shiko “Mocionet procedurale”.)
- Përgjigja e Kryeministrit të Kosovës në pyetjen e deputetit Berat Luzha (PDK) (Kjo pikë është shtyrë sepse Kryeministri nuk ishte i pranishëm për t’u përgjigjur në pyetjen. Shiko “Pyetjet për Qeverinë”.)

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

- Rendi i ditës i seancës plenare të 15, 16 dhe 19 dhjetorit nuk ishte paraqitur për miratim në Kuvend, qoftë në fund të seancës së mëparshme apo në fillim të seancës më 15 dhjetor. Në mënyrë të ngjashme, rendi i ditës për seancën e ardhshme nuk është paraqitur për miratim në Kuvend në fund të seancës më 19 dhjetor.
Kjo është në kundërshtim me rregullën 23.1, e cila kërkon që rendi i ditës për cilëndo seancë plenare të propozohet nga një anëtar i Kryesisë dhe të miratohet nga Kuvendi gjatë seancës së mëparshme. “Në fund të çdo seance, Kryetari i Kuvendit, ose një anëtar tjetër i Kryesisë, propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme. Ky propozim konsiderohet i miratuar, përveç në rastet kur një ose më shumë grupe parlamentare ose . . . gjashtë deputetë e kundërshtojnë këtë.”⁹
- Kryesia, në mbledhjen e saj më 8 dhjetor, e ka diskutuar mocionin e ORA-s, të dorëzuar më 7 nëntor, për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme plenare lidhur me çështjen e Gërmisë dhe shpenzimin e buxhetit të Kuvendit.¹⁰ Sekretari i Kuvendit tha se nuk kishte vend për një debat të tillë, dhe se administrata kishte përgatitur materialet që shpjegojnë këtë çështje mjaft mirë, dhe shtoi se për çështjen e Gërmisë është vendosur shumë më herët. Kryetari i Kuvendit propozoi që materialet t’i shpërndahen të gjithë deputetëve të Kuvendit. Z. Gazmend Muhaxheri (ORA) theksoi se ORA kishte kërkuar që të mbahej debati dhe jo vetëm të shpërndaheshin materialet shpjeguese, dhe se Kryesia duhej ta caktonte datën e mbajtjes së seancës së jashtëzakonshme në atë mbledhje. Z. Ramë Buja (PDK) tha se mbajtja e debatit për atë çështje do t’i shërbente transparencës së Kuvendit. Kryetari i Kuvendit shprehi mendimin se nuk do të ishte e arsyeshme të mbahej një debat i tillë, duke arsyetuar se Qeveria dhe PSSP-ja nuk do ta kishin miratuar një linjë të tillë buxhetore, sikur të kishte pasur parregullsi lidhur me të, dhe se Kryesia (gjatë mandatit të kaluar të Kuvendit) e kishte miratuar këtë nismë njëzëri. Z. Muhaxheri e përsëriti se nga Kryesia kërkohej që të thërriste seancën e jashtëzakonshme, meqë ORA kishte mbledhur dyzet nënshkrimet e nevojshme. Z. Naim Maloku (AAK) u pajtua se Rregullorja e obligonte Kryesinë që të thërriste seancën e jashtëzakonshme, por propozoi që më së miri do të ishte që deputetëve të Kuvendit t’u shpërndaheshin më parë materiali shpjegues në mënyrë që të përgatiteshin për debat si duhet. Diskutimi në Kryesi përfundoi pa u arritur marrëveshja për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme plenare, por me pohimin se ORA duhet të ofrojë më parë materiale shtesë.

⁹ Shiko të gjitha raportet e mëhershme të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës

¹⁰ Më 7 nëntor, grupi parlamentar ORA ka dorëzuar së bashku me nënshkrimet e 40 deputetëve në mbështetje të nismës, një mocion për mbajtjen e një seance plenare të jashtëzakonshme për ta diskutuar (1) mënyrën se si ishte marrë vendimi për ndërtimin e “Qendrës administrativo-protokollare” në parkun e Gërmisë dhe (2) shpenzimin e buxhetit të Kuvendit gjatë gjysmës së parë të vitit 2005. Si arsytim për seancën e jashtëzakonshme plenare në mocion është përmendur domosdoshmëria e përcaktimit nëse kishte pasur parregullsi procedurale gjatë procesit të vendimmarrjes dhe shpërndarjes së fondeve të Kuvendit për shpenzimet kapitale dhe shpenzimet tjera. Shiko raportin 09/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

Sipas rregullës 23.5, “Kryesia thërret . . . si përgjigje ndaj kërkesës së bërë nga . . . jo më pak se një të tretën, përkatësisht 40 deputetë në Kuvend, seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, në mënyrë që ta trajtojë një çështje të ngutshme. Kërkesa duhet të përmbajë çështjen ose çështjet që do të shqyrtohen si dhe arsyet pse ato konsiderohen të ngutshme dhe të rëndësishme që edhe në mënyrë të tillë të shqyrtohen në Kuvend. Në raste të tilla shqyrtohen vetëm çështjet që përbëjnë bazën e kërkesës.” Rregullorja nuk i obligon ata që kërkojnë seancë të jashtëzakonshme plenare të ofrojnë materiale shtesë.¹¹ Edhe pse ofrimi i materialeve shtesë do të ndihmonte në mbajtjen e një debati më të frytshëm, kjo gjë nuk kërkohet nga Rregullorja, prandaj nuk duhet të jetë parakusht për caktimin e datës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme plenare. Sipas përkufizimit, seancat e jashtëzakonshme janë çështje të ngutshme dhe duhet të trajtohen si të tilla. Në vend të kësaj, mocioni është shqyrtuar për herë të parë pas më shumë se një muaji pas dorëzimit të tij, dhe Kryesia e ka shtyrë për kohë të pacaktuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme, duke vendosur parakushte që nuk parashihen në Rregullore.¹²

- Siç është përmendur në raportet e mëhershme, ORA më 25 tetor ka dorëzuar propozimin për mbajtjen e debatit mbi “krizën në arsimin e Kosovës”, si dhe keqmenaxhimin e buxhetit të Kuvendit. Propozimi nuk është përfshirë në rendin e ditës së seancës plenare të 1 nëntorit me arsyetimin se materialet e Kryesisë tashmë u ishin shpërndarë deputetëve të Kuvendit kur ORA e ka dorëzuar propozimin e saj.¹³ Ky propozim nuk është përfshirë as në rendin e ditës së mbledhjes së rregullt të Kryesisë më 8 dhjetor, pa shpjegim.

Sipas rregullës 6.5, Kryesia “siguron që çfarëdo mocioni përmbajtësor që mbështetet nga gjashtë ose më shumë deputetë të Kuvendit, të futet në rendin e ditës të seancës plenare të Kuvendit brenda tri javësh pune, nga dita kur është marrë kjo shkallë e mbështetjes.” Afati për përfshirjen e kësaj pike në rendin e ditës së seancës plenare tashmë ka kaluar, ndërsa ende nuk është shqyrtuar në Kryesi. Mocioni duhet urgjentisht të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Kryesisë.

- Në fillim të seancës plenare të 15, 16 dhe 19 dhjetorit, z. Jakup Krasniqi (PDK) vuri re se Kuvendi po dështonte në kryerjen e obligimeve lidhur me problemet e shumta me të cilat përballet Kosova, dhe kërkoi në emër të grupit të tij parlamentar që Kuvendi të fillojë të mbajë seanca plenare çdo javë, me qëllim të intensifikimit të angazhimeve të Kuvendit. Ai propozoi që në tremujorin e parë të vitit 2006 Kuvendi, ndër të tjera, të diskutojë për: arsimin, shëndetësinë, dokumentet që do të përdoren nga grupi negociator, raportin vjetor të punës së Qeverisë, krijimin e komisionit hetimor për kontrollimin e shpenzimeve të Kuvendit dhe Qeverisë, refomimin e pushtetit lokal, dhe regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare. Ai tha se Kryesia do të duhej të konsultohet me shefat e grupeve parlamentare gjatë planifikimit të punës së Kuvendit, dhe e përsëriti se PDK-ja i konsideron seancat plenare javore si domosdoshmëri të kohës.

Znj. Teuta Sahatqija (ORA) deklaroi në emër të ORA-s se ajo i mbështeste të gjitha propozimet e z. Krasniqi. Znj. Sahatqija vuri re se miratimi i rendit të ditës është shndërruar në problem në të gjitha seancat plenare, por ndoshta Kuvendi “harron” problemet nga seanca në seancë, pasi që seancat mbahen vetëm një herë në muaj, dhe andaj të njëjtat probleme përsëriteshin kohë pas kohe. Znj. Sahatqija e lexoi rregullën 23 dhe kërkoi që në të ardhmen rendi i ditës të *propozohet* nga Kryesia për *miratim* nga Kuvendi, siç kërkohet në rregullën 23.1. Znj. Sahatqija poashtu komentoi se rregulla 23.5 që ka të bëjë me thirrjen e seancave të jashtëzakonshme plenare, nuk

¹¹ Përveç “arsyeve se pse (çështjet që do të shqyrtohen) konsiderohen të ngutshme dhe të rëndësishme ashtuqë të arsyetojë mbledhjen e Kuvendit”, të cilat ORA i ka ofruar në mocion. Shiko fusnotën 9.

¹² Shiko fusnotën 1.

¹³ Propozimi për debat plenar është dorëzuar pesë ditë para mbledhjes, shumë më herët se afati qoftë dy ose tre ditor i përmendur në të kaluarën. Pohimi se propozimi është dorëzuar pas shpërndarjes së materialeve tjera të mbledhjes deputetëve të Kuvendit nuk është arsyetim i vlefshëm për përjashtimin e propozimit nga rendi i ditës dhe është i barazvlefshëm me ndryshimin arbitrar dhe të paparalajmëruar të afatit kohor. Shiko raportin 09/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

po respektohej nga Kryesia, me ç'rast si shembull e përmendi kërkesën e ORA-s për seancë të jashtëzakonshme plenare për çështjen e Gërmisë (shiko pikën e dytë nën "Rendi i ditës", më lartë).

Shpërndarja e dokumentave

- Projektpropozimi legjislativ për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2006 është shpërndarë më 21 nëntor; projektligji për veprimtarinë botuese dhe librin është shpërndarë më 27 korrik; projektligji për institucionet e kulturës është shpërndarë më 6 tetor; projektligji për arsimin dhe aftësimin privat dhe projektligji për operën, baletin dhe filharmoninë e Kosovës janë shpërndarë më 28 tetor; projektligji për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal është shpërndarë më 31 tetor; dhe projektligji për inspektoratin e produkteve ndërtimore është shpërndarë më 25 nëntor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 17, 101, 50, 34, 35, 34, përkatësisht 15 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë të caktuar për seancën plenare të 15, 16 dhe 19 dhjetorit.

Rregulla 35.1, parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Meqë Kuvendi i mban seancat plenare vetëm një herë në muaj, është jashtëzakonisht e vështirë të caktohet shqyrtimi i parë i secilit projektligj jo më herët se dhjetë ditë pune dhe jo më vonë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij, siç kërkohet me Rregulloren e Kuvendit. Nëse, për shembull, një projektligj i dorëzohet Kuvendit dhe shpërndahet gjatë javës së tretë të muajit dhe seanca plenare mbahet gjatë javës së katërt, siç parashihet me Rregulloren e punës, projektligji nuk mund të shkojë në shqyrtim të parë gjatë po atij muaji, sepse deputetët e Kuvendit nuk do të kishin dhjetë ditë për ta studiuar projektligjin para shqyrtimit të parë. Nëse shqyrtimi i parë bëhet gjatë javës së katërt të muajit të ardhshëm, pasi të kenë kaluar përafërsisht pesë javë pune nga shpërndarja e projektligjit deri në shqyrtimin e tij të parë, atëherë shkelet Rregullorja. Kufizimi maksimal prej tri javë pune nga shpërndarja e projektligjit deri në shqyrtimin e tij të parë, që është shtuar nga vetë Kuvendi gjatë ripunimit të Rregullores së punës, është i realizueshëm vetëm nëse Kuvendi mban seanca plenare çdo javë ose së paku çdo dy javë.

Debatet

- Në fillim të seancës plenare më 15, 16 dhe 19 dhjetor, z. Ramë Buja (PDK) i përmendi spekulimet në media lidhur me blerjen e një veture të blinduar për Kryetarin e Kuvendit, në vlerë prej 236.500 Euro, nga buxheti i Kuvendit, dhe kërkoi shpjegim zyrtar për t'i dhënë fund spekulimeve. Z. Buja deklaroi se derisa nga Kryesia kërkohet që të vendosë për ndarjen e shumave të vogla, ajo nuk është konsultuar në lidhje me këtë blerje, dhe se ai nuk e kishte ditur nga kush dhe kur është marrë vendimi. Z. Buja vazhdoi duke thënë se ai shpresonte që kjo do të ishte hera e fundit që ndodh një gjë e tillë dhe përsëriti se vendimet financiare duhet të mirren nga Kryesia. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se asgjë nuk duhej fshehur nga Kuvendi apo nga qytetarët e Kosovës dhe se çfarëdo mungese e transparencës automatikisht do të shkaktonte dyshime. Ai lajmëroi se dokumentat zyrtare do të përgatiten dhe do t'i shpërndahen Kryesisë, e cila do të bëjë një vlerësim para se t'ia përcjellë komisioneve funksionale përkatëse dhe pastaj seancës plenare.

Procesi i votimit

- Kishte kuorum për të gjitha votimet në seancën plenare në fjalë. Kur Kryetari i Kuvendit po përgatitej ta ftoje Kuvendin të votojë gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit për institucionet e kulturës, ai e vërejti se nuk kishte kuorum dhe i ftoi deputetët të kthehen në sallën plenare. Votimi filloi vetëm pasi është arritur kuorumi. Gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat, deputetët dolën jashtë dhe e lënë seancën pa kuorum, por nuk është kryer asnjë votim gjatë asaj kohe. Shiko pikën e ardhshme për shpjegim më të hollësishëm. *Kjo është në pajtim me nenin 9.1.32 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullën 31.1, e cila parasheh që për marrjen e vendimeve duhet të jenë të pranishëm shumica e deputetëve.*

- Gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat, deputetët e PDK-së dhe të ORA-s propozuan që projektligji t'i kthehej Qeverisë për ripunim. Pas përfundimit të debatit kryesuesi e ftoi Kuvendin të përgatitej për votim. Duke e vërejtur se numri i deputetëve, të regjistruar si të pranishëm nga pajisjet elektronike, ishte shumë më i madh se numri i deputetëve që realisht ishin të pranishëm në sallë në atë kohë, kryesuesi kërkoi nga deputetët t'i heqin kartelat e çdo deputeti, i cili nuk ishte i pranishëm në sallë në atë kohë, dhe kërkoi nga stafi administrativ t'i numëronte me dorë deputetët në sallë. Kryesuesi lajmëroi se sipas numërimit me dorë, të pranishëm në sallë ishin 72 deputetë. Atëherë, ai e ftoi Kuvendin të votonte dhe i lexoi me zë rezultatet e votimit ashtu siç ishin regjistruar nga pajisjet elektronike: 41 për, 31 kundër dhe tre abstenime. Disa deputetë tërhoqën vërejtjen lidhur me mospërputhjen në mes të numërimit me dorë (72) dhe numrit të përgjithshëm të votave dhe abstenimeve (75), dhe kryesuesi konkludoi se ishte e nevojshme që të përsëritej votimi. Atëherë, deputetët e PDK-së dhe ORA-s dolën nga salla plenare, duke e lënë seancën pa kuorum. Në atë moment, Kryetari i Kuvendit u kthye në seancë plenare. Z. Fatmir Rexhepi (LDK) e informoi Kryetarin e Kuvendit se “41 kanë votuar për, 31 kundër, 72 janë të pranishëm, dhe dy kanë abstenuar, prandaj unë konsideroj se projektligji është miratuar.” Z. Alush Gashi (LDK) bëri vërejtjen se LDK-ja kishte kërkuar që kur Kryetari i Kuvendit nuk është i pranishëm, ai gjithmonë duhej të zëvendësohej nga dikush nga i njëjti grup parlamentar, dhe se sikur të ndiqej ky parim, Kuvendi nuk do të ballafaqohej me çështjen procedurale në fjalë. Z. Xhavit Haliti (PDK) u përgjigj se mënyra se si kryesohen seancat plenare nuk ka të bëjë asgjë me grupet parlamentare. Ai deklaroi se tre deputetë *jo të pranishëm në sallën plenare* kishin votuar dhe i këshilloi deputetët se nuk mund t'i delegojnë votat e tyre deputetëve të tjerë, kur e lëshojnë sallën plenare. Z. Haliti tha se *ai po e kryesonte seancën kur ndodhi incidenti dhe sipas Rregullores së Kuvendit, ai e kishte autoritetin përfundimtar në interpretimin e Rregullores në atë kohë. Kryetari i Kuvendit e falënderoi z. Haliti për ndihmën në kryesimin e seancës, dhe shtoi se z. Fatmir Sejdiu (LDK) dhe z. Naim Maloku (AAK) mungonin, andaj nuk mund ta zëvendësonin atë në kryesimin e seancës plenare. Kryetari i Kuvendit e pranoi se Rregullorja i jep kryesuesit të drejtën e interpretimit të Rregullores gjatë seancës plenare. Në mungesë të kuoromit, ai e mbylli seancën plenare për atë ditë. Të nesërmën, Kryetari i Kuvendit konstatoi se kryesuesi kishte vepruar në mënyrë korrekte kur ka provuar ta përsëris votimin gjatë ditës së kaluar dhe e ftoi Kuvendin që edhe një herë ta votojë projektligjin, i cili është miratuar me shumicë votash për dhe me 23 vota kundër.*
Në një raport të mëhershëm është përshkruar një rast i ngjashëm kur vëzhguesit në galerinë e pasme kanë vërejtur një deputete duke votuar në pajisjen e saj si edhe në pajisjen e kolegut afër saj, i cili përkohësisht e kishte lëshuar sallën plenare.¹⁴ Mundësitë e tilla për manipulim dhe pasaktësi duhet të eliminohen në mënyrë që të ruhet integriteti i procesit të votimit. Nisma e kryesuesit për të kërkuar nga deputetët t'i heqin kartelat e deputetëve jo të pranishëm nga pajisja elektronike kishte për qëllim ta sillte numrin e deputetëve të regjistruar elektronikisht në përputhje me numrin e deputetëve që realisht ishin pranishëm në sallën plenare, por siç duket kartelat e të paktën tre deputetëve jo të pranishëm në sallë kishin mbetur në pajisje. Do të mund të ndihmonte më tutje nëse, në të ardhmen, Kryetari i Kuvendit apo kryesuesi i thërrasin gjithmonë deputetët përmes altoparlantit që të kthehen në sallë kur vjen koha për të votuar, në vend se t'i thërrasin vetëm në rastet kur nuk ka kuorum. Nëse deputetët vazhdojnë t'i lëjnë kartelat e tyre në pajisjet, kur dalin nga salla plenare, Kryesia do të mund të merrte parasysh masa më radikale siç është mbajtja e të gjithë votimeve pandërprerë, pas përfundimit të të gjitha debateve përkatëse. Në një sistem të tillë, cilido deputet që dëshiron ta lëshojë seancën përkohësisht gjatë debateve do të kishte dukshëm më shumë motivim për t'u kthyer në sallë për të votuar.

¹⁴ Secili deputet ka një kartelë elektronike identifikimi, qe duhet të futet në pajisjen e tij apo saj për t'u regjistruar si i pranishëm në sallë dhe për t'i mundësuar atij ose asaj të votojë. Deputetët janë udhëzuar që gjithmonë t'i mbajnë kartelat e tyre elektronike identifikuese me vete, por ata shpesh i lëjnë kartelat në pajisje kur e lëshojnë sallën përkohësisht. Shiko raportin 04/2004 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

Formimi i grupit të ri parlamentar

- Më 1 dhjetor, z. Ferid Agani (PD – Partia e Drejtësisë) e kishte dorëzuar një letër “të bazuar në kapitullin IV të Rregullores së Kuvendit . . . dhe rregullës 11.3,” me të cilën e njoftonte Kryetarin e Kuvendit se më 23 nëntor, ai dhe deputetët në vazhdim kishin vendosur ta formojnë grupin parlamentar të quajtur “Për integrim”: z. Gjergj Dedaj (PLK – Partia Liberale e Kosovës), z. Sabit Rrahmani (PDAK – Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës), z. Numan Balić (SDA – Partia për Aksion Demokratik), z. Rustem Ibişi (GIG – Iniciativa Qytetare e Gorës), dhe z. Zylfi Merxha (PReBK – Partia e Bashkuar Rome e Kosovës). Z. Agani e ka informuar Kryesinë se ai do të shërbejë si shef i grupit parlamentar gjatë tre muajve të parë sipas një plani të rotacionit për të gjithë anëtarët e grupit parlamentar

Në fillim të seancës plenare më 15 dhjetor, por pasi kishin folur disa deputetë, z. Gjergj Dedaj (“Për Integrim” - PLK) deklaroi se meqë Kryetari i Kuvendit nuk i kishte informuar deputetët lidhur me formimin e grupit të ri parlamentar, këtë do ta bënte ai vetë. Z. Dedaj deklaroi se ai dhe deputetët e tjerë e kishin formuar grupin parlamentar për t’i përmirësuar mundësitë e tyre që të marrin pjesë plotësisht në Kuvend. Ai bëri vërejtjen se partitë në pushtet nuk po bëjnë mjaft për t’i mbrojtur të drejtat e komuniteteve pakicë dhe deklaroi se anëtarësimi në grupin parlamentar “Për Integrim” do ta ndihmojë integrimin e tyre më të shpejtë dhe më të plotë në shoqërinë kosovare. Z. Dedaj komentoi se ai është përpjekur të fliste mbi tridhjetë herë në gjashtë muajt e fundit në Kuvend, por nuk i është dhënë fjala asnjëherë. Z. Dedaj kërkoi që, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, anëtarët e grupit parlamentar “Për Integrim” të përfshihen në të gjitha fushat e punës së Kuvendit, siç janë komisionet.

Kryetari i Kuvendit u përgjigj se ai kishte pasur ndër mend ta informonte Kuvendin lidhur me formimin e grupit të ri parlamentar gjatë pikës së 12-të të rendit të ditës, miratimi i emërimit të z. Mahir Yagcilar (6+/KDTP) për anëtar të Kryesisë së Kuvendit, si zëvendësim i z. Džezair Murati (6+/Vakat).

Gjatë debatit të Buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin 2006, pasi nga një deputet kishte folur në emër të LDK-së, PDK-së, AAK-së, ORA-s, dhe 6+, z. Dedaj kërkoi fjalën në emër të grupit parlamentar “Për Integrim”. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se ai tashmë i kishte thënë z. Dedaj se ai do ta informonte Kuvendin lidhur me grupin e ri parlamentar gjatë “pikës përkatëse” të rendit të ditës dhe se “duhet të ndjeket procedura”. Ai i tha z. Dedaj se do t’i ipej fjala më vonë gjatë debatit, së bashku me deputetët e tjerë të Kuvendit. Pasi kishin folur disa deputetë të tjerë, z. Dedaj i ishte dhënë fjala dhe ai pyeti nëse i ishte dhënë fjala në emër të grupit parlamentar apo thjesht si deputetit të Kuvendit. Ai shtoi se z. Ferid Agani është shefi aktual i grupit parlamentar, por nuk ishte i pranishëm atë ditë.

Më 16 dhjetor, Kryetari i Kuvendit nuk ia ka dhënë fjalën asnjë deputeti për të folur në emër të grupit parlamentar “Për Integrim” në fillim të debateve për projektligjet, kur deputetët e tjerë bënë deklarata në emër të grupeve të tyre parlamentare, por poashtu asnjëri nga anëtarët “Për Integrim” nuk e kërkoi fjalën në emër të grupit parlamentar. Më 19 dhjetor, Kryetari i Kuvendit e ftoi z. Ferid Agani të fliste në emër të grupit parlamentar “Për Integrim” gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit për operën, baletin dhe filharmoninë e Kosovës. Z. Agani deklaroi se meqë grupi i tij parlamentar është formuar së voni, ende nuk kanë pasur mundësinë ta shqyrtojnë projektligjin si grup, andaj ai nuk mund të paraqiste mendimin unik të grupit, por shtoi se do të fliste më vonë gjatë debatit, dhe do t’i paraqiste pikëpamjet e veta për këtë projektligj.

Sipas rregullës 11 (kapitulli IV i Rregullores), gjashtë ose më shumë deputetë të Kuvendit mund të formojnë një grup parlamentar të bazuar në qëllimin e përbashkët politik, dhe grupi parlamentar e informon Kryesinë e Kuvendit lidhur me emrin e shefit të saj dhe anëtarëve të tjerë.¹⁵ Rregullorja i jep të drejtën Kryesisë në shpërndarjen e fondeve grupit parlamentar (rregulla 11.6) dhe të propozojë ndarjen e pozitave të komisioneve parlamentare në mes të grupeve parlamentare (rregulla 41.1 dhe 42.3) por nuk i jep rol në formimin e grupeve

¹⁵ Shiko rregullat 11.1 dhe 11.3: “Grupi parlamentar është grupim politik i përbërë nga jo më pak se 5 për qind, përkatësisht 6 deputetë të Kuvendit në funksion të një qëllimi politik të përbashkët . . . Emri i kryetarit dhe i anëtarëve të grupit parlamentar i komunikohen me shkrim kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit.”

parlamentare siç është miratimi i nismës. Grupi “Për Integrim” automatikisht është shndërruar në grup parlamentar kur të gjashtë deputetët e Kuvendit kanë vendosur ta formojnë këtë grup dhe kur e kanë informuar Kryesinë. Prandaj, ata tashmë ishin grup parlamentar kur filloi seanca plenare më 15 dhjetor; themelimi i grupit nuk varej më nga asnjë procedurë e mëtutjeshme. Andaj, grupit “Për Integrim” është dashur t’i ipej fjala në fillim të debatit për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës, kur deputetët e tjerë po bënin deklaratë në emër të grupeve të tyre parlamentare. Rregullorja e Kuvendit parasheh që gjatë debatit për çfarëdo projektligji apo mocioni të rëndësishëm, shefit të secilit grup parlamentar¹⁶ i lejohet të flasë në emër të grupit parlamentar para se të flasin të gjithë deputetët e tjerë. Praktika e Kuvendit është që grupeve parlamentare t’u ipet fjala sipas rendit zbritës, në përputhje me numrin përkatës të vendeve që i kanë në Kuvend. Andaj, grupit “Për Integrim”, me gjashtë vende, është dashur që automatikisht t’i ipet fjala ose pas ORA-s (shtatë vende) ose 6+ (gjashtë vende) gjatë çdo debati.

Përfaqësimi i Qeverisë në seanca plenare

- Pas paraqitjes së buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin 2006 nga ana e Ministrit për ekonomi dhe financa Haki Shatri (LDK) në seancën plenare të 15 dhjetorit, z. Alush Gashi (LDK) e shprehi befasinë e tij për mungesën e Kryeministrit. Z. Jakup Krasniqi (PDK) komentoi se jo vetëm Kryeministri, por i tërë kabineti qeveritar duhet të jetë i pranishëm kur debatohet buxheti dhe se ishte “skandalozë” të debatohej buxheti i Qeverisë në mungesë të Qeverisë.¹⁷ Znjsh. Gjylnaze Sylja (AAK) deklaroi se Kryeministri ka planifikuar të jetë i pranishëm gjatë diskutimit të buxhetit, por ka qenë i informuar se ajo është pika e katërt e rendit të ditës e jo e para. Ajo propozoi që të informohej Kryeministri lidhur me ndryshimin e rendit të ditës dhe të bëhej një pauzë e shkurtër deri sa të arrinte ai. Kryeministri erdhi dhe seanca vazhdoi, por pas nje kohe të shkurtër ai prapë shkoi, dhe nuk u kthye më gjatë debatit të mbetur. Më vonë gjatë debatit, z. Berat Luzha (PDK) komentoi poashtu se nuk dukej shumë serioze të debatohej në mungesë të shumicës së ministrave. Gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin, z. Genc Gorani (ORA) bëri vërejtjen se tre ligje të rëndësishme që vinin nga Ministria për kulturë, rini, sport dhe çështje jorezidente ishin në rendin e ditës atë ditë, por si dukej Ministri “nuk donte ta modifikonte agjendën e tij për të ardhur në seancë.” Z. Gorani komentoi se mungesa e Ministrit Haraqija ishte “sistematike” dhe e ftoi Kryesinë të merrej seriozisht me këtë çështje.
- Para se ta thërriste zëvendësministren për kulturë, rini, sport dhe çështje jorezidente, Angjelina Krasniqi, që ta paraqiste projektligjin për veprimtarinë botuese dhe librin më 16 dhjetor, Kryetari i Kuvendit lajmëroi se, “për të shmangur çfarëdo paqartësie në të ardhmen” e kishte marrë një dokument nga Qeveria në të cilin konfirmohet se zëvendësministrat janë të autorizuar t’i paraqesin projektligjet në seanca plenare, meqë ata janë zgjedhur nga Kuvendi. Më 19 dhjetor, z. Hydajet Hyseni (PDK) komentoi se Kuvendi po toleronte praktikën që projektligjet të paraqiten nga zëvendësministrat në vend të ministrave, duke argumentuar se me Rregulloren të Kuvendit kërkohet që projektligji të paraqitet nga ministrat. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se ai pajtohej “gati plotësisht” dhe se ai dhe sekretari aktualisht po përgatisin një plan pune që do ta trajtojë edhe këtë çështje.

Në asnjë dispozitë të Rregullores së Kuvendit nuk përmendet roli i zëvendësministrave, përkatësisht as nuk lejohet e as nuk ndalohet pjesëmarrja e tyre në seanca plenare. Rregulla 33.1 parasheh që projektligjet mund të paraqiten për shqyrtim në Kuvend nga Qeveria (ndër të tjera) por nuk e saktëson se Qeveria duhet të përfaqësohet nga Ministri e jo nga zëvendësministri. Në mungesë të çfarëdo akti relevant ligjor të Kuvendit, kjo çështje rregullohet vetëm me Rregulloren e Qeverisë. Neni 77.2 i Rregullores së Qeverisë parasheh që “në rast të mungesës së ministrit që ka për të prezentuar një projektligj atë e zëvendëson zëvendësministri,

¹⁶ Në praktikë, një përfaqësues tjetër i autorizuar i grupit parlamentar shpesh flet në emër të grupit parlamentar në vend të shefit të grupit.

¹⁷ Në atë moment, përveç Ministrit Shatri vetëm tre ministra ishin të pranishëm.

e në mungesë të këtij të dytit Kryeministri, zëvendëskryeministri ose një ministër tjetër i caktuar nga Kryeministri.” Nuk është në fushën e përgjegjësive së këtij raporti mbi monitorimin e Kuvendit që të komentojë më tutje rreth asaj nëse Qeveria vepron në përputhje me Rregulloren e saj. Pyetja nëse zëvendësministrat janë të autorizuar ta përfaqësojnë Qeverinë në seanca plenare është ngritur disa herë, dhe për herë të fundit në seancën plenare të 17/21 nëntorit.¹⁸

Pyetjet për Qeverinë

- Në fund të seancës plenare më 19 dhjetor, pika e fundit e rendit të ditës (përgjigja e Kryeministrit të Kosovës në pyetjen e deputetit të Kuvendit Berat Luzha (PDK)) është shtyrë sepse Kryeministri nuk ishte i pranishëm të përgjigjej në pyetjen. Z. Luzha deklaroi se ai e kishte dorëzuar pyetjen e tij lidhur me Ligjin për lojërat e fatit më 3 shtator dhe rikujtoi se Kryeministri nuk ishte i pranishëm edhe gjatë seancës së kaluar për t’u përgjigjur në pyetjen. Z. Luzha komentoi se mungesa e Kryeministrit në dy seanca tregon ose mungesën e respektit ndaj Kuvendit ose frikën nga ballafaqimi me pyetjet e deputetëve. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se ai nuk dinte çfarë të bënte veçse ta thërriste edhe një herë Kryeministrin ose ta shtyente këtë pikë të rendit të ditës për seancën e radhës. Shumë deputetë të Kuvendit thanë se kjo çështje duhet shtyrë dhe u ngritën në këmbë duke u përgatitur për t’u larguar dhe duke lënë të kuptohej se e konsideronin seancën plenare të përfunduar. Atëherë, Kryeministri arriti në sallën plenare në atë moment, por punimet e seancës plenare megjithatë u ndërpreu.

Siç është përmendur edhe në raportin paraprak, nuk është e qartë nëse Kryeministri është udhëzuar të jetë i pranishëm në seancën plenare të 17/21 nëntorit për t’u përgjigjur në pyetjet gojarisht.¹⁹ Duke pasur parasysh vërejtjet e z. Luzha dhe të tjerëve²⁰ lidhur me vonesat e Qeverisë për t’u përgjigjur në pyetjet, është befasuese që Kuvendi e ka shtyer përgjigjen e Kryeministrit në pyetjen e z. Luzha përkundër arritjes së tij në sallën plenare.

Interpelanca

- Kryesia, në mbledhjen e saj më 8 dhjetor, e ka shqyrtuar interpelancën me të cilën thirrjet Ministrja për shërbime publike Melihate Tërmkollli (LDK) t’u përgjigjet akuzave për shkelje të Ligjit për menaxhimin e financave publike, Ligjit për prokurim publik, dhe të Rregullores 2001/36 të UNMIK-ut mbi shërbimin civil në Kosovë, të dorëzuar nga PDK-ja më 25 tetor. Kryesia është pajtuar pa diskutim që t’ia përcjellë mocionin Qeverisë.

Sipas rregullës 25, “propozimin për shqyrtimin e një çështjeje të caktuar lidhur me punën e Qeverisë ose të ministrive, mund të paraqesin jo më pak së dhjetë (10) deputetë . . . Interpelanca i parashtrohet Kryesisë së Kuvendit. Kryesia e Kuvendit, menjëherë sapo ta ketë marrë tekstin e interpelancës, ia dërgon Qeverisë, që është e detyruar ta shqyrtojë brenda jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditësh . . . Interpelanca vihet në rendin e ditës në afatin prej dhjetë (10) ditësh, pasi të merret përgjigja nga Qeveria. Në qoftë se Qeveria nuk e dërgon përgjigjen lidhur me interpelancën brenda pesëmbëdhjetë ditësh, interpelanca vihet si pikë e

¹⁸ Shiko raportet 01/2005, 05/2005 dhe 09/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

¹⁹ Shiko raportin 06/2005 të shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës. Kryeministri nuk ishte i pranishëm në seancën plenare për t’u përgjigjur në pyetjet e z. Berat Luzha (PDK) dhe z. Ramadan Kelmendi (LDK). Dihej se ai ishte në takim të grupit negociator atë pasdite në kohën kur janë diskutuar pyetjet në seancë plenare. As Kryesuesi as ndonjëri prej deputetëve të Kuvendit (përveç z. Luzha, shiko më poshtë) nuk lanë të kuptohej se kishin pritur që Kryeministri të ishte i pranishëm në seancë plenare për t’u përgjigjur me gojë. Kryesuesi përmendi se Kryeministri nuk ishte i pranishëm, por lajmëroi se ishin dorëzuar përgjigjet me shkrim dhe pyeti z. Kelmendi dhe z. Luzha nëse kishin komente në përgjigjet. Z. Kelmendi u përgjigj se ishte i kënaqur me përgjigjen që kishte marrë, por z. Luzha deklaroi se nuk ishte i kënaqur me përgjigjen në pyetjet e tij, dhe shtoi se ai kishte kërkuar përgjigje gojore dhe u ankua se Qeveria po i neglizhonte përgjegjësitë e saj ndaj Kuvendit. *Të dy, edhe z. Kelmendi edhe z. Luzha kishin kërkuar përgjigje gojore në pyetjet e tyre. Edhe pse në kërkesën e z. Luzha nuk thuhej shprehimisht se kërkonte “përgjigje gojore”, në kërkesë megjithatë citohej rregulla 26, e cila merret vetëm me përgjigjet gojore, e jo me përgjigjet me shkrim. Sidoqoftë, duket se Kryesia i ka përfshirë pyetjet në rendin e ditës duke mos pritur që Kryeministri t’i paraqesë përgjigjet gojarisht në seancë plenare. Është dashur të kërkohej nga Kryeministri që të përgjigjet gojarisht në të dy grupet e pyetjeve.*

²⁰ Z. Hydajet Hyseni (PDK), për shembull, lajmëroi gjatë seancës se ai e kishte dorëzuar një pyetje për Ministrin për kthim dhe komunitete Slaviša Petković para më shumë se tre muajve, por ende nuk kishte marrë përgjigje.

fundit në rendin e ditës të seancës plenare të Kuvendit që është duke u zhvilluar. Nëse Kuvendi nuk është për seancë, atëherë ajo vihet si pikë e parë në rendin e ditës së seancës së parë të radhës të Kuvendit. Kuvendi nuk mund ta refuzojë vënien e interpelancës për shqyrtim në rendin e ditës, përveç në rast se ajo nuk i plotëson kushtet formale sipas paragrafit 3 të kësaj rregulle.”²¹ Kryesia nuk e ka shqyrtuar mocionin e interpelancës në mbledhjen e saj më 1 nëntor dhe prandaj nuk ia ka përcjellur interpelancën Qeverisë “sapo e ka marrë tekstin e interpelancës”, siç kërkohet nga rregulla 25.²²

Pajisjet elektronike të votimit

- *Siç është përmendur në pikën e dytë nën “Procesi i votimit”, mundësia ekzistuese për pasaktësi dhe manipulim gjatë votimit duhet të trajtohet.*
- *Gjatë tërë votimit në seancë plenare, sistemi i ngjyrave që paraqet votat për, votat kundër dhe abstenimet, ndryshoi disa herë. Votat për janë paraqitur me ngjyrë të gjelbër, portokalltë dhe kaltër të çeltë. Gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit për gjuetinë, votat për fillimisht janë paraqitur me të gjelbër dhe votat kundër me të portokalltë. Më pas, papritmas sistemi i ngjyrave ndryshoi nga njëri amandament në tjetrin, me ç’rast votat për u paraqitën me të portokalltë ndërsa votat kundër me të gjelbër.*
Ky problem teknik është komentuar në raportet e mëhershme.²³ Secili lloj i votave duhet vazhdimisht të paraqitet me një ngjyrë, në mënyrë që rezultatet e votimit të shfaqen më qartë. Kur janë zëvendësuar ngjyrat e votave për dhe votave kundër gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit për gjuetinë, rezultati i votimit dukej si pikërisht i kundërt, posaçërisht për ata të cilët nuk mund t’i shohin numrat e që duhet të mbështeten në ngjyra.

Mocionet procedurale

- *Kah fundi i seancës plenare më 19 dhjetor, z. Hydajet Hyseni (PDK), kryesues i Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese, e lexoi me zë rekomandimin e komisionit lidhur me mocionin e dorëzuar nga ORA.²⁴ Z. Hyseni shtoi se një numër dispozitash të Rregullores nuk po respektohen, siç është rregulla 8, e cila parasheh që Kryetari i Kuvendit i thërret seancat plenare e jo sekretari i Kuvendit; rregullat 7.5 dhe 23.3 mbi konsultimin e Kryesisë me shefat e grupeve parlamentare; dhe rregulla 23 mbi propozimin e rendit të ditës së seancës plenare nga Kryesia dhe miratimin e tij nga Kuvendi. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se ai e kishte anuluar seancën plenare të 26 gushtit, sepse ai ishte informuar nga Qeveria se Kryeministri nuk do të mund të ishte i pranishëm në seancë plenare, dhe se partitë opozitare kishin deklaruar se ata nuk do vinin nëse Kryeministri nuk do të ishte aty. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se pajtohej që Rregullorja duhet të respektohet, por ajo duhet të respektohet në tërësi dhe nga të gjithë deputetët dhe jo vetëm nga ai dhe Kryesia. Ai e përsëriti se zyra e tij ishte duke e hartuar një plan pune që do ta obligojë tërë Qeverinë të jetë e pranishme në seanca plenare dhe të përgjigjet me kohë në pyetjet e parashtruara nga deputetët e Kuvendit. Ai shtoi se Kryesia ishte përpjekur për tre vite edhe gjatë mandatit të kaluar, kur z. Hyseni ishte anëtar i Kryesisë, që t’i përgatisë rendet e ditës të seancave plenare mjaft kohë paraprakisht në mënyrë që ta paraqes secilin rend të ditës për miratim nga Kuvendi gjatë seancës paraprake, por mungesa e informacionit e kishte bërë këtë të pamundur. Z. Hyseni u përgjigj se ai vetëm sugjeronte që Kuvendi duhej të fillojë ta përmirësojë praktikën dhe se ndoshta do të ishte e dobishme të*

²¹ Rregulla 25.3 parasheh që mocioni duhet të jetë me shkrim dhe të përfshijë: “formulimin e saktë të çështjes që është lëndë e interpelancës, konkluzionin që propozohet dhe arsyetimin, emrin dhe mbiemrin e deputetit, që e ka parashtruar interpelancën në Kuvend, si dhe nënshkrimet e deputetëve, që e mbështetin interpelancën.”

²² Shiko raportin 09/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

²³ Shiko raportin 06/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

²⁴ Shiko raportin 08/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës. Më 24 gusht, grupi parlamentar ORA i ka dorëzuar Kryesisë një mocion në të cilin pohonte se mënyra se si seanca plenare e planifikuar për 26 gusht ishte anuluar përmes një e-maili nga administrata e Kuvendit, duke cituar “për shkaqe teknike”, përbënte shkelje procedurale. Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese e ka diskutuar mocionin më 10 tetor dhe ka konstatuar se mocioni i ORA-s ishte i bazuar dhe se “Rregullorja duhet të respektohet.”

mbahej një debat plenar për funksionimin e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se “debat do të ketë gjithmonë, por jo edhe lojëra politike që janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Rregulloren.”

Vërejtjet e Kryetarit të Kuvendit lidhur me vështirësitë në miratimin e rendit të ditës janë në përputhje me vërejtjet e përfshira në raportet e mëhershme: “Siç është përmendur në të gjitha raportet e mëhershme që nga shkurti 2004 e tutje, caktimi i rendeve të ditës është bërë tejet problematik që kur Kuvendi ka filluar t’i mbajë seancat plenare në baza mujore në shkurt 2004. Në mbledhjet e saj para çdo seance plenare, Kryesia as që provon të caktojë të paktën rendin e ditës për seancën plenare pas seancës së radhës, për shkak të paqartësisë se cilat pika do të jenë të gatshme për shqyrtim pas një muaji.” Në këtë kuptim, sistemi aktual mujor i mbajtjes së seancave plenare nuk është në përputhje me Rregulloren e punës.²⁵

4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

- Gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit mbi veprimtarinë botuese dhe librin më 16 dhjetor, z. Džezair Murati (6+) bëri vërejtjen se “asnjë përfaqësues nga komunitetet tjera” nuk ishte i përfshirë në grupin punues që e ka hartuar projektligjin dhe shtoi se grupi i tij parlamentar kishte kërkuar disa herë që “ta ketë të paktën një përfaqësues në grupet punuese qeveritare.” Ngjashëm, edhe znj. Nuran Malta (6+) komentoi gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit për arsimin dhe aftësimin privat se dukej se “asnjë përfaqësues i minoriteve nuk është i përfshirë në hartimin e këtij ligji.”

Vërejtje të ngjashme janë ngritur në disa raste në Kuvend.²⁶ Më 8 prill 2005, Kryeministri ka nxjerrë një “Vendim për përfshirjen e ekspertëve në grupet punuese për hartimin dhe vlerësimin e projektligjeve,” i cili parasheh që sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit duhet t’i përfshijë përfaqësuesit e komuniteteve minoritare në grupet punuese për hartimin e projektligjit që është “i rëndësishëm për minoritetet kombëtare apo interesat e tyre” por nuk është e qartë nga teksti se mbi çfarë baze përcaktohet se cilat projektligje janë të rëndësishme për interesat e komuniteteve.²⁷

5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancën plenare, në mbledhjen e rregullt të Kryesisë dhe në të gjitha komisionet. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

6. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar vetëm transmetim të pjesshëm të seancës plenare në fjalë. Seanca plenare është transmetuar drejtpërdrejt në televizion më 15 dhjetor, por më 16 dhe 19 dhjetor janë transmetuar vetëm orët e para të seancës. Në rastet e mëhershme, kur seancat plenare zgjasnin deri në mbrëmje, RTK-ja e fillonte transmetimin e programit të saj të rregullt në ora 17:00 dhe pjesën tjetër të seancës plenare e transmetonte më vonë atë mbrëmje. Sidoqoftë, më 16 dhe 19 dhjetor RTK-ja e ka ndërprerë transmetimin e seancës plenare mjaft kohë para orës 17:00 dhe nuk e ka transmetuar pjesën tjetër të seancës, as më vonë gjatë asaj mbrëmjeje. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) ka bërë vërejtjen gjatë seancës plenare më 19 dhjetor se seancat plenare janë publike sipas rregullës 24, dhe se secila familje po e parapaguan transmetimin e RTK-së, prandaj duhet ta kenë mundësinë t’i përcjellin seancat plenare në RTK.

²⁵ Për komente më të detajzuara, shiko pikën e parë nën “Rendi i ditës” në raportin 09/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës dhe raporte të mëhershme.

²⁶ Shiko raportet 02/2005 dhe 01/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

²⁷ Vendimi Nr. 041/2005, 08 prill 2005.

Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web faqen (www.kuvendikosoves.org, www.skupstinakosova.org, www.assemblyofkosovo.org). që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera.

FUND.